

Vendim nr. 273 datë 20.12.2023

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 20.12.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Nj) 2023 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga deputetët Oerd Bylykbashi, Flamur Noka dhe avokatët Ivi Kaso dhe Franci Nuri, me autorizim.

OBJEKTI: **Interpretimi përfundimtar i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe SPAK-ut e GJKKO-së për sa i takon çështjes së heqjes dhe/ose kufizimit të lirisë së deputetit të Kuvendit në çdo formë, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit.

Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit Sali Berisha, të kërkuara nga SPAK-u e të vendosura nga GJKKO-ja (me vendimet nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimin nr. 56, datë 21.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar), pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit.

Pezullimi i masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit Sali Berisha derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet me vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 6, 7, 38, pika 2, 73, pika 2, 124, 131, pika 1, shkronja “ç”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, paragrafi i parë, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 118, 119 e vijues të Rregullores së Kuvendit, të ndryshuar; nenet 288 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) në datën 19.10.2023 i ka kërkuar, mes të tjerave, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*) caktimin e masave shtrënguese “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i KPP-së dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të parashikuar nga neni 233 i KPP-së, për shtetasin Sali Berisha, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), nën hetim për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar në nenet 260 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*).

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, mes të tjerave, ka vendosur pranimin e kërkesës për caktimin e masave shtrënguese sikurse ka kërkuar Prokuroria e Posaçme. Në datën 23.10.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur njoftimin për zbatimin e masës së sigurimit personal. Në vijim, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023, ka verifikuar zbatimin e masës së sigurimit

personal dhe ka vendosur vazhdimin e saj; urdhërimin e shtetasit nën hetim të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, para oficerit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme; urdhërimin për të mos u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1, të KPP-së dhe ndalimin e përdorimit të pasaportës dhe dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

3. Kundër vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023 ka paraqitur ankim edhe deputeti Sali Berisha nëpërmjet mbrojtësve të tij.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*), me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, të verifikuar me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 të së njëjtës gjykatë.

5. Në datën 14.12.2023 kërkuesi, një grup prej 30 deputetësh, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar: (i) interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, i cili parashikon: *“Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit”*; (ii) zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe Prokurorisë së Posaçme e Gjykatës së Posaçme për çështjen e heqjes dhe/ose kufizimit të lirisë së deputetit të Kuvendit në çdo formë, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit; (iii) konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit nën hetim, të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme e të vendosura me vendimet nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit; (iv) pezullimin e masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit Sali Berisha, derisa Gjykata të shprehet me vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje.

6. Në datën 19.12.2023 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë një kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, duke parashtruar se në datën 21.12.2023 është caktuar seanca plenare e Kuvendit për dhënien e autorizimit për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për arrestin e deputetit Sali Berisha.

7. Kolegji i Gjykatës, në datën 19.12.2023, pasi ka marrë në shqyrtim paraprak çështjen, ka vendosur ta kalojë atë për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

8.1. *Për juridiksionin e Gjykatës*

8.1.1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, përkatësisht pushtetit legjislativ dhe pushtetit gjyqësor, duhet t'i nënshtrohet vlerësimin të Gjykatës, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronjat "ç" dhe "e", të Kushtetutës.

8.2. *Për legjitimimin e kërkuetit*

8.2.1. Kërkueti plotëson kriterin formal të legjitimitetit *ratione personae*, pasi kërkesa është nënshkruar nga të paktën 28 deputetë të Kuvendit. Për sa i takon legjitimitetin substancial, si subjekt i pakushtëzuar jo më pak se një e pesta e deputetëve nuk ka detyrimin për të provuar lidhjen mes veprimtarisë ligjore që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Kërkuetit, pjesë e institucionit të Kuvendit, si subjekt kushtetues i është mohuar kompetenca për t'u shprehur me votë lidhur me dhënien ose refuzimin e autorizimit paraprak për kufizimin e lirisë, në çdo lloj forme, të një deputeti të Kuvendit. Vetëm Kuvendi ka në kompetencë të diskutojë e të vendosë me votë për lejimin ose jo të kufizimit të lirisë së deputetit, në çdo formë, kur kjo kërkohet në rrugë institucionale nga organi i prokurorisë. Vendimet e marra nga Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit, duke mos kërkuar autorizimin paraprak të Kuvendit përpara miratimit të masave shtrënguese, janë bërë baza për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave mes pushtetit legjislativ, nga njëra anë, dhe pushtetit gjyqësor, nga ana tjetër. Kërkueti legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, si dhe deklarimin si antikushtetuese të vendimeve të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës së Posaçme, që kanë shërbyer si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave kushtetuese. Kompetenca e Kuvendit, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja, është me natyrë kushtetuese dhe e parashikuar drejtpërdrejt nga Kushtetuta (neni 73, pika 2). Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit, në kundërshtim me Kushtetutën, e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur nëse

duhet pyetur ose jo Kuvendi, përpara vendosjes së masave shtrënguese që kufizojnë lirinë e deputetit, duke vendosur me vullnetin e tyre për mosdërgimin e kërkesës në Kuvend. Për rrjedhojë, vendimmarrjet e tyre, për sa i takon refuzimit për t'iu drejtuar Kuvendit me kërkesë për lejimin e vendosjes së masave të sigurimit personal ndaj deputetit, nuk janë të pajtueshme me Kushtetutën.

8.3. *Për themelin e kërkesës*

8.3.1. *Për mosmarrëveshjen e kompetencave dhe interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës*

8.3.1.1. Neni 73, pika 2, i Kushtetutës është mjaft i qartë dhe nuk lejon keqinterpretime. Kjo dispozitë përcakton kufijtë e paprekshmërisë së deputetëve të Kuvendit. Detyrimi i prokurorit për të kërkuar autorizimin nga Kuvendi sanksionohet edhe në nenin 288 të KPP-së. Togfjalëshi “heqja e lirisë në çfarëdolloj forme”, krahas rasteve si “arrestin në burg ose në shtëpi” apo “kontrolli personal ose i banesës” nuk mund të interpretohet sikur detyrimi për t'iu drejtuar Kuvendit ekziston vetëm në rastet e heqjes së plotë të lirisë, por duhet të ishte zbatuar edhe në rastin konkret. Kufizimi i pjesshëm i lirisë së deputetit, duke e detyruar atë të paraqitet në organin procedues apo duke i hequr lirinë për të udhëtuar jashtë shtetit, përbëhet nga forma të ndryshme të heqjes dhe kufizimit të lirisë së deputetit, duke e penguar atë në ushtrimin e detyrave të tij. Edhe neni 118 i Rregullores së Kuvendit parashikon dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme. Ndërkohë që neni 73, pika 2, i Kushtetutës përdor vetëm termin “arrest”, Kuvendi në nenin 118 të Rregullores nuk i kufizon masat e heqjes/kufizimit të lirisë vetëm tek arrestin në burg ose shtëpi, por në çdo formë tjetër heqjeje të lirisë, përfshirë heqjen e përkohshme të lirisë të daljes jashtë shtetit ose të lirisë për të lëvizur në çdo moment/kohë në çdo pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë, lirisht dhe pa asnjë kufizim nga askush, siç parashikon neni 38 i Kushtetutës. Detyrimi për të marrë autorizim për paprekshmërinë fizike dhe të banesës së deputetit të Kuvendit bashkë me arrestin, përcakton kufijtë e paprekshmërisë nga masat e sigurimit personal në çdo formë, si pjesë e imunitetit parlamentar. Vendosja e një mase sigurimi

ndaj deputetit ndikon edhe në përmbushjen kolektive të një numër institutesh, instrumentesh ose procedurash parlamentare. Duke tejkaluar detyrimin kushtetues dhe ligjor për të kërkuar dhe marrë paraprakisht autorizimin për vendosjen e masave shtrënguese ndaj lirisë së një deputeti, Kuvendit i janë hequr dhe uzurpuar kompetencat që i njej Kushtetuta, përfshirë të drejtën e anëtarëve të tij për të kryer verifikim formal të kërkesave të ardhura nga ana e organit procedues, përpara se ky organ të shprehet me votë lidhur me refuzimin ose miratimin e vendosjes së këtyre masave. Kompetenca për kufizimin e lirisë së deputetit, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, ndahet ndërmjet dy organeve, nga njëra anë, prokurorisë e gjykatës dhe, nga ana tjetër, Kuvendit, sipas rolit përkatës që Kushtetuta i ngarkon secilit prej tyre. Në rastet e kufizimit të lirisë së deputetit, në çdo lloj forme, organi i prokurorisë është i detyruar t'i kërkojë Kuvendit dhënien e miratimit paraprak dhe ky i fundit është i detyruar të marrë në shqyrtim kërkesën e organit procedues. Procedura duhet të bazohet në *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe luajalitetit kushtetues* dhe është detyrë e Gjykatës të imponojë ligjshmërinë kushtetuese për sjelljen e organeve kushtetuese. Gjykata duhet të vlerësojë se neni 73, pika 2, i Kushtetutës e trajton kufizimin e lirisë të deputetit si proces të përbashkët dhe asnjë nga institucionet (prokuroria/gjykata/Kuvendi) nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë i vetëm.

8.3.2. *Për kufizimin e lirisë së deputetit pa miratim paraprak të Kuvendit, cenohen:*

8.3.2.1. *Neni 38, pika 2, i Kushtetutës, i cili garanton lirinë e çdo shtetasi shqiptar që të mos privohet nga e drejta për të udhëtuar jashtë shtetit. Po kështu, ky nen parashikon lirinë e çdo shtetasi për të lëvizur në çdo pjesë të territorit shqiptar. Në të dyja rastet liria lidhet jo vetëm me të drejtën për të lëvizur lirisht në hapësirë, por edhe në çdo kohë që shtetasi zgjedh ta bëjë këtë. Prokuroria dhe gjykatat e posaçme kanë vendosur me vullnetin e tyre për mosdërgimin e kërkesës në Kuvend, me argumentin se masat shtrënguese nuk konsiderohen “heqje”, por “kufizim” i lirisë, megjithëse Kushtetuta parashikon se autorizimi kërkohet për “çdo lloj forme”. Arresti në çdo formë të tij përbën kufizim të përkohshëm të lirisë së shtetasit, që në thelb është heqje e lirisë. Po kështu, edhe heqja e lirisë*

për të dalë jashtë kufijve apo për të lëvizur pa kufizim në territorin e shtetit në çdo moment, përbën kufizim të përkohshëm të të drejtave në atë masë që e heqin lirinë. Përdorimi i togfjalëshit “çdo lloj forme” për kufizimin e lirisë tregon qartë se secila nga dy masat shtrënguese të vendosura ndaj deputetit nën hetim i cenon atij lirinë e lëvizjes brenda dhe jashtë vendit, për rrjedhojë organi procedues kishte detyrimin që t’i drejtohej Kuvendit me kërkesë për të marrë autorizimin, sikurse ka vepruar në një rast të ngjashëm.

8.3.2.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit kanë vendosur masa kufizuese të lirisë së deputetit, i cili gëzon imunitet parlamentar, pa i kërkuar paraprakisht Kuvendit miratimin për këto masa, në kushtet kur legjislacioni përcakton procedurën që duhet ndjekur. Nisur nga fakti se kjo gjë ndodh për herë të parë, ndryshe nga rastet e deputetëve të tjerë, ku prokuroria ka kërkuar marrjen e autorizimit nga Kuvendi, në rastin konkret ndodhemi në kushtet e cenimit të parimit të sigurisë juridike.

8.3.2.3. *Nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së*, pasi deputetit i është hequr liria në kuptim të Konventës, si dhe kjo heqje është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, pra me parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Për sa i takon nenit 5 të KEDNJ-së, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka interpretuar se heqja e lirisë nuk kufizohet vetëm te situata klasike e ndalimit pas një arrestimi ose dënimi, por ka edhe trajta të tjera. Për rrjedhojë, edhe masat shtrënguese të vendosura ndaj deputetit klasifikohen si “heqje e lirisë”. Për sa i përket së drejtës për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së, heqja dhe kufizimi i lirisë ndaj deputetit është bërë duke mos respektuar ligjin procedural penal, Rregulloren e Kuvendit, dispozitat kushtetuese, si dhe duke ndërmarrë veprime në thelb arbitrare. Në këtë mënyrë, vendosja e këtyre masave shtrënguese është në kundërshtim edhe me jurisprudencën e *GJEDNJ-së*, e cila është shprehur se heqja e lirisë duhet të bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe në përputhje me qëllimin e ndjekur për mbrojtjen e individit nga arbitrariteti.

8.4. *Për kërkesën për pezullim*

- 8.4.1. Gjykata duhet të vendosë pezullimin e masave shtrënguese të sigurimit personal derisa vendimi përfundimtar i saj të hyjë në fuqi, pasi çështja është sensitive, prioritare dhe cenon kompetencat e institucionit të Kuvendit, si dhe njëkohësisht të liderit të opozitës.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për juridiksionin e Gjykatës

9. Kërkuesi ka pretenduar se zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, përkatësisht pushtetit gjyqësor dhe atij legjislativ për shkak të vendimeve të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë dhe të Apelit, të cilat kanë vendosur masa kufizuese të lirisë së deputetit të Kuvendit, që gëzon imunitet parlamentar, pa i kërkuar paraprakisht Kuvendit miratimin për vendosjen e tyre dhe për pasojë interpretimi përfundimtar i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronjat “ç” dhe “e”, të Kushtetutës.

10. Në nenin 124 të Kushtetutës parashikohet se Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca interpretuese e saj, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, nuk nënkupton formulimin e interpretimeve tërësisht abstrakte të normës kushtetuese, pasi kjo do ta vinte Gjykatën në rolin e organit që jep opinione këshillimore për mënyrën se si duhet të veprojnë në të ardhmen institucionet kushtetuese. Në rast se Gjykata do të jepte vendime interpretuese *in abstracto*, duke mos u shprehur përfundimisht për kushtetutshmërinë e aktit që ka ardhur si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë përkatëse të subjektit, ky vendim do të merrte karakteristikat e kontrollit paraprak të kushtetutshmërisë (*shih vendimin nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi, që përbën subjektin kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave

ndërmjet Kuvendit, nga njëra anë, dhe Prokurorisë së Posaçme e Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit, nga ana tjetër, për shkak të dhënies prej këtyre të fundit të dy masave të sigurimit personal ndaj një deputeti, pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit, duke kërkuar për këtë qëllim edhe interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës.

13. Në përmbajtjen e kërkesës kërkuesi ka identifikuar si bazë ligjore shkronjën “e” të nenit 131 të Kushtetutës, e cila parashikon juridiksionin e Gjykatës për të vendosur për çështjet që lidhen, ndër të tjera, me zgjedhshmërinë e papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Në lidhje me këtë të fundit, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt ose argument për të treguar lidhjen midis kësaj dispozite kushtetuese dhe kërkesës së paraqitur, prandaj Mbledhja e Gjyqtarëve nuk do ta marrë atë në shqyrtim.

14. Ndërsa si bazë ligjore të kërkesës së tij kërkuesi ka përcaktuar nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, kompetencë e cila hyn në juridiksionin e Gjykatës dhe do të analizohet në vijim.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit

15. Kërkuesi ka parashtruar se plotësohet kriteri formal i legjitimitimit *ratione personae*, pasi kërkesa është nënshkruar nga të paktën 28 deputetë të Kuvendit. Për sa i takon legjitimitimit substancial, ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës si subjekt që ka legjitimitet të pakushtëzuar dhe nuk ka detyrimin për të provuar lidhjen mes veprimtarisë ligjore që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Kërkuetit, pjesë e institucionit të Kuvendit, si subjekt kushtetues i është mohuar kompetenca për t’u shprehur me votë lidhur me dhënien ose refuzimin e autorizimit paraprak për kufizimin e lirisë, në çdo lloj forme të një deputeti të Kuvendit. Vetëm Kuvendi ka në kompetencë të diskutojë e të vendosë me votë për lejimin ose jo të kufizimit të lirisë së deputetit, në çdo formë, kur kjo kërkohet në rrugë institucionale nga organi i prokurorisë. Vendimet e marra nga Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme, duke mos kërkuar autorizimin paraprak të Kuvendit përpara miratimit të masave shtrënguese, janë bërë baza për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave mes pushtetit legjislativ, nga njëra anë dhe pushtetit gjyqësor, nga ana tjetër. Kërkuesi legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, si dhe deklarimin si antikushtetuese të vendimeve të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës së Posaçme, që kanë shërbyer si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave kushtetuese. Kompetenca e Kuvendit, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja, është me natyrë kushtetuese dhe e parashikuar drejtpërdrejt nga Kushtetuta

(neni 73, pika 2). Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme, në kundërshtim me Kushtetutën, e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur nëse duhet pyetur ose jo Kuvendi paraprakisht përpara vendosjes së masave shtrënguese që kufizojnë lirinë e deputetit, duke vendosur me vullnetin e tyre mosdërgimin e kërkesës në Kuvend. Për rrjedhojë, vendimmarrjet e tyre, për sa i takon refuzimit për t'iu drejtuar me kërkesë për lejimin e vendosjes së masave të sigurimit personal ndaj deputetit të Kuvendit, nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.

16. Duke pasur parasysh pretendimet e ngritura nga kërkuesi, si dhe referuar objektit të kërkesës, sikurse u theksua më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se është paraqitur për zgjidhje një konflikt kompetencash ndërmjet organeve kushtetuese, për shkak të masave të sigurimit personal të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme dhe të vendosura nga Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit ndaj një deputeti, pa marrë më parë autorizim nga Kuvendi sipas përcaktimeve të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Për këtë arsye është kërkuar edhe interpretimi i kësaj dispozite kushtetuese, e cila përcakton kompetencën e Kuvendit për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit ose për heqjen e lirisë së tij në çfarëdolloj forme apo kur ndaj tij ushtrohet kontroll personal ose i banesës. Si pasojë, është kërkuar edhe konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit nën hetim që kanë shërbyer si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, si dhe pezullimi i tyre. Prandaj, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkimet për interpretimin e Kushtetutës dhe antikushtetutshmërinë e masave shtrënguese kanë të bëjnë me mosmarrëveshjen kushtetuese të parashtruar për t'u zgjidhur, pra konfliktin e kompetencave. Për rrjedhojë, në vijim, do të analizohet legjitimitimi i subjektit kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, për të vënë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave.

17. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në rastet e konfliktit të kompetencave është e domosdoshme të ketë një mosmarrëveshje konkrete, pasi zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* (shih vendimet nr. 36, datë 01.06.2015; nr. 4, datë 01.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Gjithashtu, një mosmarrëveshje kompetence, që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë të parashikuara nga Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të përcaktohet si e tillë po nga dispozitat kushtetuese. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatë përqendrohet, pikësisht, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke

gjetur dhe cilësuar të papajtuëshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 36, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata, po në jurisprudencë të vazhdueshme, ka pohuar se konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e së njëjtës kompetencë ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (*shih vendimet nr. 12, datë 20.05.2008; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 26, datë 04.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk e kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon që sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre (*shih vendimet nr. 26, datë 25.05.2021; nr. 48, datë 08.11.2011; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kur një grup deputetësh vë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, duhet që ai të argumentojë se është subjekt i parashikuar nga Kushtetuta dhe se i është cenuar një kompetencë e caktuar e parashikuar po nga Kushtetuta. Gjithashtu, ai duhet të pretendojë se është subjekt në konflikt ose është cenuar drejtpërdrejt në ndonjë kompetencë. Nëse këto elemente nuk arrijnë të identifikohen në kërkesën e parashtruar përpara Gjykatës, nuk mund të arrihet në një analizë dhe përfundim të qartë se cilit organ i takon të ushtrojë cilën kompetencë, si qëllimi final i shqyrtimit që bën Gjykata në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave.

20. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka parashtruar se legjitimohet në paraqitjen e kërkesës si subjekt që ka legjitimitet të pakushtëzuar dhe nuk ka detyrimin për të provuar lidhjen mes veprimtarisë ligjore që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të theksojë se në jurisprudencën kushtetuese interesi i jo më pak se një të pestës së deputetëve nuk është vënë në diskutim në gjykimet e kontrollit kushtetues abstrakt. Ndër këto raste kontrolli, në ato të shqyrtimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjeve ose akteve normative në mënyrë të vazhdueshme, Gjykata ka vlerësuar se në zbatim të nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, interesi i këtij grupi parlamentar për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si: konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar. Në këtë kuptim, ky subjekt ka të drejtë të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimet nr. 35, datë 15.06.2023; nr. 18, datë 07.07.2022; nr. 41, datë 16.05.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Ndryshe paraqitet situata në rastet e mosmarrëveshjes së kompetencave, të cilat lidhen me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kushtetuese konkrete. Në këto raste subjekti kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve duhet të ketë pozitën e subjektit në konflikt ose të cenuar drejtpërdrejt në ndonjë kompetencë të tij, si dhe të argumentojë se ndodhet përpara një mosmarrëveshjeje kompetencash kushtetuese. Sikurse është shprehur edhe Gjykata, kur një grup deputetësh vë në lëvizje gjykimin kushtetues për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, ai duhet të parashtrojë se midis cilave organe ekziston konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë (*shih vendimin nr. 25, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet nr. 51, datë 07.03.2023; nr. 59, datë 26.02.2014; nr. 34, datë 08.04.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

22. Nisur nga sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në një arsyetim *a contrario* nëse do të pranohej ideja që një subjekt kushtetues ka interes të pakushtëzuar për çdo lloj konflikti të perceptuar prej tij si mosmarrëveshje kompetencash midis organeve kushtetuese, atëherë do të lindte rreziku që potencialisht subjekte/organe kushtetuese të treta, që nuk janë mbartëse të kompetencës kushtetuese në konflikt, t'i drejtoheshin Gjykatës në vend të subjekteve/organeve të cilave u përket kjo kompetencë, çka do të krijonte një mjet të panatyrshëm ankimi kushtetues, që nuk pajtohet me parimin e ndarjes së pushteteve dhe që nuk është e pajtueshme dhe me funksionin e kontrollit kushtetues për këtë qëllim. Me fjalë të tjera, sikurse është theksuar edhe në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimin nr. 25, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), thjesht fakti se dy entitete ose organe kushtetuese kanë mendime të ndryshme për kushtetutshmërinë e një akti, nuk është shkak i mjaftueshëm për të konkluduar në ekzistencën e një konflikti të kompetencave. Prandaj, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se në rastet e konfliktit të kompetencave kërkuesi duhet të plotësojë kriteret kushtetuese, si në aspektin formal (numri minimal prej 28 i deputetëve kërkues), ashtu edhe në atë substancial (të provuarit e interesit).

23. Në rastin konkret, kërkesa është nënshkruar nga 30 deputetë, prandaj kërkuesi legjitimohet në aspektin formal. Për sa i takon aspektit substancial, nisur nga pretendimet e paraqitura në kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi, jo më pak se një e pesta e deputetëve, duke parashtruar se janë vendosur masa kufizuese të lirisë së një deputeti të Kuvendit, pa i kërkuar paraprakisht këtij të fundit autorizimin sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, është përqendruar në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së Kuvendit dhe jo të të drejtave të tij si pakicë parlamentare. Kërkuesi, duke pohuar se konflikti i kompetencave që

kërkohet të zgjidhet është ndërmjet Kuvendit, nga njëra anë, dhe prokurorisë dhe gjykatave të posaçme, nga ana tjetër, nuk ka paraqitur argumente që të provojnë se është palë në konfliktin e kompetencave apo se moszgjidhja apo ekzistenca e këtij konflikti ka cenuar kompetencat e tij dhe rrjedhimisht ushtrimin e të drejtave të njohura atij nga Kushtetuta.

24. Gjithashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se nëse kërkuesi pretendon se ka një konflikt, në të cilin nuk është palë apo nuk e cenon në ushtrimin e funksioneve të tij, që është në kundërshtim me normat kushtetuese, në këtë rast ai nuk mund t'i drejtohet Gjykatës nëpërmjet kërkimit të zgjidhjes së konfliktit të kompetencave midis dy organeve. Mbrojtja e kushtetutshmërisë, si qëllimi final i kontrollit kushtetues, është një e drejtë/detyrë e subjekteve të përcaktuara në dispozitat kushtetuese, në të cilat përcaktohen edhe rastet konkrete kur ata mund të vënë në lëvizje Gjykatën.

25. Në kuptim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se Kushtetuta ka parashikuar rastet kur grupeve të deputetëve u janë njohur të drejta si entitete kushtetuese (midis të cilave një e katërta e deputetëve në rastet e komisioneve hetimore dhe një e dhjeta e deputetëve në rastet e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit). Në këtë drejtim, një e pesta e deputetëve dhe Kuvendi janë subjekte kushtetuese të ndryshme, që nuk mund të barazohen me njëri – tjetrin. Prandaj, referuar mosmarrëveshjes së pretenduar të kompetencave, kërkuesi nuk është subjekt në konflikt, si dhe nuk rezulton t'i jetë marrë ndonjë kompetencë apo të jetë cenuar drejtpërdrejt në ndonjë kompetencë. Pavarësisht se kërkuesi, grupi jo më pak se një e pesta e deputetëve, është pjesë e pushtetit ligjvënës, kjo nuk nënkupton që është subjekti kushtetues për të cilin bën fjalë neni 73, pika 2, i Kushtetutës (Kuvendi). Ai nuk mund të veprojë në emër dhe me tagrat e Kuvendit dhe as të barazohet me të, për këtë arsye kërkuesi, nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet organeve kushtetuese, Kuvendit, nga njëra anë, dhe Prokurorisë së Posaçme e Gjykatës së Posaçme, nga ana tjetër. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se antikushtetutshmëria e vendimeve gjyqësore që pretendohet se përbën shkakun e lindjes së konfliktit të kompetencave, nuk mund të merret në shqyrtim.

26. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se vendimet gjyqësore të kundërshtuara, duke qenë se i drejtohen një deputeti konkret janë ngushtësisht personale, për rrjedhojë kundërshtimi i tyre eventualisht edhe pranë Gjykatës, pas shterimit të mjeteve të zakonshme të ankimit, është në të drejtën e atij individit interesat e të cilit cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se deputeti, në cilësinë e individit, gëzon të drejtën kushtetuese për t'iu drejtuar kësaj Gjykate kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi

gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, në përputhje me parashikimet e nenit 131, pika, 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

27. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi një e pesta e deputetëve, nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare. Në kushtet kur kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet e tij, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 8577/2000, vlerëson se edhe kërkimi për pezullimin e masave shtrënguese nuk mund të merret në shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese , në bazë të neneve 31, 31/a, pika 2, shkronja “b” dhe 54 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 3 (Nj) 2023 të Regjistrit Themeltar, me kërkues jo më pak se një e pesta e deputetëve, jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe në vijim parashtraj argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër në këtë çështje.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke kërkuar në objektin e kërkesës: interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës; zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe SPAK-ut e GJKKO-së për sa i takon çështjes së heqjes dhe/ose kufizimit të lirisë së deputetit të Kuvendit në çdo formë, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit; konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit, të kërkuara nga

SPAK-u e të vendosura nga GJKKO-ja, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit; pezullimin e masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit.

3. Duke trajtuar fillimisht nëse ka juridiksion për të shqyrtuar çështjen, shumica ka vlerësuar se kërkuesi ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit ligjvënës, Kuvendit, nga njëra anë, dhe atij gjyqësor, Prokurorisë së Posaçme e Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit, nga ana tjetër, për shkak të dhënies prej këtyre të fundit të dy masave të sigurimit personal ndaj deputetit, pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit, duke kërkuar për këtë qëllim edhe interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Sipas saj, nga kërkuesi, si bazë ligjore e kërkesës, është përcaktuar neni 131, pika 1, shkronja “ç”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, çështje që hyn në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafët 12 dhe 14 të vendimit*).

4. Në linjë me qëndrimin tim në çështje të ngjashme (*shih mendimet e pakicës në vendimet nr. 141, datë 28.10.2022; nr. 51, datë 07.03.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*), vlerësoj se shumica, sërish dhe mbi të njëjtat argumente, ka ndryshuar objektin e kërkesës, si edhe shkakun dhe bazën ligjore të saj, duke i bashkuar kërkimet drejt një mosmarrëveshjeje të vetme, edhe pse ato janë të ndryshme për nga shkakun dhe baza ligjore. *Së pari*, në ndryshim nga sa shprehet shumica, kërkuesi ka përcaktuar qartësisht në kërkesë nenin 124 të Kushtetutës, që është baza ligjore ku ai mbështet kërkimin e parë, për sa kohë që në nenin 131 të Kushtetutës nuk ka një germë të veçantë që i referohet kompetencës interpretative të normës kushtetuese. Sigurisht që kërkuesi ka përcaktuar edhe nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, por të lidhur me kërkimin vijues të tij për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave. *Së dyti*, natyra e pretendimeve dhe shkakun ligjor i kërkesës janë elementet që përcaktojnë juridiksionin kushtetues të Gjykatës dhe jo thjesht citimi në kërkesë i normave kushtetuese dhe/ose ligjore.

5. Kërkuesi, jo më pak se një e pesta e deputetëve, është një nga subjektet kushtetuese që është legjitimuar nga jurisprudenca kushtetuese për kërkesa me objekt interpretimin e normës kushtetuese (*interpretimi i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës (vendimi nr. 39, datë 23.06.2000); interpretimi i neneve 96 dhe 97 të Kushtetutës (vendimi nr. 28, datë 21.02.2002); interpretimi i neneve 128, 140, 149, pika 2, të Kushtetutës (vendimi nr. 75, datë 19.04.2002); interpretimi i nenit 77, pika 2, të Kushtetutës (vendimi nr. 18, datë 14.05.2003); interpretimi i neneve 65/1 dhe 78/2 të Kushtetutës (vendimi nr. 59, datë 23.12.2014), etj.*).

6. Interpretimi i ligjit themelor, përveçse një kompetencë e veçantë e Gjykatës, e cila i trajton çështje të tilla si kërkesa të mëvetshme, kryhet edhe në çdo rast tjetër kur ajo vepron në

kuptim të kompetencave kushtetuese sipas nenit 131 të Kushtetutës, që ushtrohen në zbatim dhe interpretim të normës kushtetuese, që do të thotë edhe pa qenë nevoja të vihet në lëvizje me kërkesë të veçantë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka përcaktuar kritere të veçanta nga rastet e tjera, duke theksuar se në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës duhet të plotësohen disa kushte: *së pari*, norma që kërkohet të interpretohet duhet të jetë e paqartë dhe si pasojë e kësaj paqartësie që ajo mbart dhe kuptimit që i është dhënë ka lindur një “problem/mosmarrëveshje kushtetues/e; *së dyti*, kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet normës konkrete kushtetuese dhe fakteve, mosmarrëveshjeve ose çështjeve të përcaktuara konkretisht në një ose disa akte të organit kompetent, si pasojë e zbatimit ose kuptimit të padrejtë të kësaj norme kushtetuese; *së treti*, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar (*shih vendimet nr. 29, datë 30.06.2011, nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 59, datë 01.04.2014 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Kur një grup deputetësh vë në lëvizje Gjykatën për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, duhet të pretendojë dhe të argumentojë se ka më shumë se një interpretim ose zbatim të ndryshëm të Kushtetutës dhe se nga ky fakt kanë ardhur pasoja të tilla që kanë shkaktuar nevojën për një interpretim përfundimtar të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 25, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke iu referuar këtij kërkimi të kërkesës, shumica duhej të kishte vlerësuar nëse ndodhej para rasteve që lejojnë interpretimin e parashikimit kushtetues. Trajtimi i shumicës mendoj se nuk krijon qartësinë që duhet të japë vendimi i Gjykatës Kushtetuese gjatë analizës së normave kushtetuese, për arsye se edhe pse në kërkesë ka kërkime të ndryshme që përfshihen nën “ombrellën” kushtetuese, ato janë bashkuar duke u anashkaluar shqyrtimi i tyre në mënyrë të shkëputur. Është e vërtetë se kërkuesi ka pretenduar se ka lindur edhe një konflikt kompetencash midis organeve, por thelbi i kërkimeve, në fakt, është mënyra e interpretimit të normës kushtetuese dhe jo e anashkallimit, siç pretendon shumica. Nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 29, datë 30.06.2011; nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky është edhe thelbi i kërkimit të parë të kërkesës, që është anashkaluar tërësisht, pra që të përcaktohej në këtë konflikt kushtetues nëse veprimtaria e organeve të përfshira është brenda sinorit kushtetues dhe në vijim

nëse pasojat e ardhura nga kjo kanë shkaktuar edhe konflikt të kompetencave. Në përmbledhje, kërkimi për lindjen e një konflikti të kompetencave në të njëjtën mënyrë si ai për pezullimin e masave, është i ndërlidhur me interpretimin e Kushtetutës dhe jo *vice versa*.

8. Në vlerësimin tim kërkuesi ka arritur të justifikojë nevojën për një interpretim përfundimtar të dispozitës kushtetuese. Edhe pse sipas tij norma nuk ka paqartësi në mënyrën se si shprehet, pra në formulimin e saj, mënyra se si ajo është interpretuar e bën të detyrueshme një interpretim përfundimtar nga Gjykata, vendimi i së cilës do të ishte detyrues për zbatim në këtë rast. Kërkuesi ka provuar se konflikti kushtetues ka ardhur nga zbatimi i normës kushtetuese, e detyrueshme për zbatim në rastin konkret dhe se ajo ka lidhje me çështjen konkrete për zgjidhjen e së cilës shërben edhe interpretimi përfundimtar i dispozitës kushtetuese. Sipas kërkuesit, prokuroria dhe gjykatat e posaçme kanë vendosur me vullnetin e tyre mosdërgimin e kërkesës në Kuvend, në ndryshim nga si është vepruar në rastin e disa deputetëve të tjerë, ku prokuroria ka kërkuar marrjen e autorizimit nga Kuvendi, çka provon se ndodhemi para qëndrimeve të ndryshme të shprehura përmes vendimeve të organeve që zbatojnë normën kushtetuese. Edhe pse Kuvendi nuk është shprehur me vendim për mënyrën e interpretimit të normës, kjo ka ardhur për shkak se organet gjyqësore i kanë dhënë asaj një interpretim të ndryshëm nga praktika e mëparshme, qëndrim që ka vënë në pamundësi Kuvendin të shprehet dhe të ushtrojë funksionin e tij kushtetues. Për rrjedhojë, kryerja e një interpretimi përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës bëhej e domosdoshme, pasi krijonte mundësinë e mënjanimin të mosmarrëveshjeve apo paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre.

9. Dua të ritheksoj edhe në këtë çështje qasjen e njëjtë me rastet ku kam mbajtur qëndrim në pakicë, se shumica, pa qenë e qartë në linjën e arsyetimit të saj, e ka shndërruar një konflikt/mosmarrëveshje të pastër kushtetues, në një konflikt të kompetencave, që edhe pse përbën një kërkim të veçantë të kërkesës, ka natyrë dhe shkak të ndryshëm nga ai për interpretimin e Kushtetutës. Do të dëshiroja që edhe në këtë rast të vë në dukje paqartësinë në vijim të arsyetimit të vendimit, ku shumica analizon kriteret e legjitimitetit formal dhe substancial tërësisht në mënyrë formale, vlerësim që nuk shkon në linjë me qasjen e saj ndaj përcaktimit se çfarë/cili është një subjekt në konflikt. Në vlerësimin tim, për sa kohë që ishte evidentuar një konflikt me natyrë kushtetuese nga organet që kanë një rol të caktuar në këtë proces, plotësoheshin kushtet për fillimin e gjykimit kushtetues për interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, ndaj duhej të ishte vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Në vijim të qëndrimit tim në pakicë, vlerësoj se kërkuesi legjitimohet në rastin konkret edhe për kërkimin për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave midis organeve të pushtetit.

11. Sipas shumicës, në jurisprudencën kushtetuese interesi i një të pestës së deputetëve nuk është vënë në diskutim në gjykimet e kontrollit kushtetues abstrakt, por ndryshe paraqitet situata në rastet e mosmarrëveshjes së kompetencave, që lidhen me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kushtetuese konkrete, në të cilat ai duhet të ketë pozitën e subjektit në konflikt ose të cenuar drejtpërdrejt prej tij, si dhe të argumentojë se ndodhet përpara një mosmarrëveshjeje kompetencash kushtetuese (*shih paragrafët 20 dhe 21 të vendimit*). Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave është kontroll kushtetues konkret, që lidhet me një çështje konkrete dhe që vihet në lëvizje vetëm nga subjekti në konflikt ose i cenuar drejtpërdrejt prej tij. Thjesht fakti se dy entitete ose organe kushtetuese kanë mendime të ndryshme për kushtetutshmërinë e një akti, nuk është shkak i mjaftueshëm për të konkluduar në ekzistencën e një konflikti të kompetencave (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Po sipas shumicës, një e pesta e deputetëve dhe Kuvendi janë subjekte kushtetuese të ndryshme që nuk mund të barazohen me njëri – tjetrin. Prandaj, referuar mosmarrëveshjes së pretenduar të kompetencave, kërkuesi nuk është subjekt në konflikt, si dhe nuk rezulton t'i jetë marrë ndonjë kompetencë apo të jetë cenuar drejtpërdrejt në ndonjë kompetencë. Pavarësisht se kërkuesi është pjesë e pushtetit ligjvënës, kjo nuk nënkupton që është subjekti kushtetues për të cilin bën fjalë neni 73, pika 2, i Kushtetutës (Kuvendi). Ai nuk mund të veprojë në emër dhe me tagrat e Kuvendit dhe as të barazohet me të. Prandaj, kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet pushtetit gjyqësor dhe atij ligjvënës (*shih paragrafin 25 të vendimit*).

12. Gjykata në vendimin e saj nr. 42/2022 ka vënë në diskutim për herë të parë, referuar praktikës gjermane, se cili është subjekti kushtetues që mund të nisë kontrollin kushtetues në lidhje me komisionet hetimore për sa kohë Kushtetuta ka përcaktuar në mënyrë të qartë numrin e deputetëve që përbën atë grupim që merr trajtën e një subjekti kushtetues. Ajo ka vlerësuar se jo çdo entitet brenda Kuvendit, që formalisht përbën një të katërtën e deputetëve, ka të drejtë të paraqesë kërkesë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të një entiteti tjetër (pakica parlamentare), por vetëm ai grupim që e ka ushtruar ose kërkon ta ushtrojë efektivisht këtë të drejtë. Gjykata vlerësoi në atë vendim se grupi i deputetëve, të cilëve norma kushtetuese u ka njohur të drejta si entitete, përfshi edhe të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, nuk nënkupton dhe nuk barazohet me organizimin politik të deputetëve apo partive politike që

veprojnë brenda Kuvendit. Qasja e Gjykatës në atë vendim qartësisht lidhet me të drejtat dhe kompetencat që Kushtetuta u ka njohur entiteve të ndryshme brenda Kuvendit, për të cilat ka përcaktuar trajtën e tyre, cilësinë në të cilën veprojnë dhe kompetencat që mund të ushtrojnë.

13. Siç shprehet edhe shumica në vendim, mbrojtja e kushtetutshmërisë, si qëllimi final i kontrollit kushtetues, është një e drejtë/detyrë e subjekteve të përcaktuara qartë në dispozitat kushtetuese, në të cilat përcaktohen edhe rastet konkrete kur ato mund të vënë në lëvizje Gjykatën. Në rastin konkret shumica nuk ka përcaktuar, dhe një gjë e tillë nuk rezulton as përmes arsytimit të saj, se cili është subjekti që mund të vërë në lëvizje Gjykatën në një rast të tillë apo se cili subjekt mund t'i drejtohet Gjykatës në ato raste kur Kushtetuta nuk ka përcaktuar atë grupim/entitet për të cilin lindin të drejta të caktuara. A është Kryetari i Kuvendit? A është shumica parlamentare? Cila është mënyra e vënies në lëvizje të Gjykatës në një rast të tillë kur një organ tjetër interpreton Kushtetutën në mënyrë arbitrare dhe ushtron kompetenca që i përkasin ekskluzivisht një organi tjetër?

14. Konsideroj po kaq të rëndësishme të theksoj se qëndrimi im në pakicë nuk përbën ndonjë shprehje nga qëndrimi i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese ndër vite, që citohet në mënyrë të plotë dhe ezauruese nga shumica dhe, sigurisht, as ndryshim nga qëndrimet e mia të mëparshme. Si gjyqtare kushtetuese respektoj parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike po aq sa edhe atë të koherencës dhe qëndrueshmërisë së jurisprudencës kushtetuese. Qasja ime është e ndryshme nga shumica vetëm për qëndrimin se standardet dhe parimet e elaboruara nga Gjykata në jurisprudencën e saj duhet të zbatohen në linjë me frymën e Kushtetutës dhe qëllimin që kushtetutëbërësi ka synuar, po aq sa edhe qëllimin e vetë Gjykatës, e cila nuk ka synuar të lihet jashtë kontrollit të kushtetutshmërisë veprimtaria e organeve kushtetuese që i përkasin secilit prej pushteteve të shtetit.

15. Jo në pak raste Gjykata ka vënë theksin se për nga natyra e pretendimeve dhe e procesit gjyqësor në tërësi, gjykatat e zakonshme nuk duhej të mbanin qasje formaliste, por të ushtronin funksionin e tyre kushtetues dhe ligjor duke synuar të drejtën. E njëjta qasje nuk më rezulton në rastin konkret, duke mbajtur kjo Gjykatë qasje formaliste dhe duke u shndërruar interpretimi i saj në kufizues të mbrojtjes së kushtetutshmërisë përmes kufizimit të të drejtave kushtetuese të subjekteve që vetë Kushtetuta u ka njohur një mision dhe rol të posaçëm dhe të veçantë në strukturën kushtetuese, veçanërisht në nenin 134 të lidhur në mënyrë të ngushtë me nenin 131 të Kushtetutës. Gjykata, ndërsa u ka hapur dyert shumë subjekteve të kufizuara, duke bërë interpretime të zgjeruara në mënyrë që të garantojë mbrojtjen kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore, ka kufizuar aksesin e një subjekti të pakushtëzuar, i cili i drejtohet asaj

vetëm me qëllim garantimin e parimeve të kushtetutshmërisë dhe shtetit të së drejtës në ushtrimin e kompetencave nga organet e shtetit, çka është misioni themelor i kësaj Gjykate.

16. Në çështjet për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (vendimet nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023) kam mbajtur qëndrimin në pakicë, duke vlerësuar se procedura e zhvilluar nga Kuvendi nuk mund të përjashtohet nga kontrolli kushtetues. Për shkak të statusit kushtetues të Kuvendit, si organ përfaqësues i popullit, mund të konkludohet se në parim kontrolli parlamentar i referohet të gjithë aktivitetit shtetëror dhe të gjitha autoriteteve publike, por një kompetencë e tillë nuk e transformon Kuvendin në një superorgan të pushtetit të shtetit. Kam vlerësuar në atë rast se nëse Kuvendi nuk vë në lëvizje Gjykatën në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës për kontrollin e pajtueshmërisë së mandatit të deputetit, e vetmja mënyrë e përfshirjes së Gjykatës është kërkesa e një të pestës së deputetëve, si një subjekt i pakushtëzuar që i lind kjo e drejtë në kuptim të përmbajtjes së neneve 131, pika 1, shkronja “e” dhe 134, pika 1, shkronja “c”. Për të mos lënë pa kontroll veprimtarinë e Kuvendit dhe duke pasur parasysh rolin e pakicës parlamentare, kam theksuar se është vetëm ky subjekt kushtetues, pra një e pesta e deputetëve, që ka të drejtën të nisë një gjykim kushtetues edhe në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.

17. Së njëjtës qasje i qëndroj edhe në rastin konkret. E drejta e një të pestës së deputetëve të Kuvendit është e lidhur me rolin që ka ky subjekt në mbrojtjen e interesit publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret, për shkak të interesit të këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë (*shih vendimet nr. 21 datë 18.04.2023; nr. 18, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Neni 73, pika 2, i Kushtetutës ka parashikuar se deputeti nuk mund të arrestohet ose të hiqet liria në çfarëdoj forme pa autorizimin e Kuvendit. Sipas nenit 13 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin përbëhet nga 10 deputetë, dhe ai, mes të tjerash, shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin ose heqjen e lirisë në çfarëdoj forme, ose ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti në përputhje me nenin 73 të Kushtetutës. Sipas nenit 118 të Rregullores së Kuvendit kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdoj forme, apo për kontrollin personal ose të banesës i paraqitet Kryetarit të Kuvendit nga prokurori dhe ai ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren,

Imunitetin dhe Mandatet, duke vënë në dijeni edhe deputetin. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli brenda 2 javëve harton raportin për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme apo kontrollit personal ose të banesës. Raporti i Këshillit u shpërndahet deputetëve. Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme apo kontrollit personal ose të banesës të një deputeti vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Kuvendi vendos me votim të hapur për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme apo kontrollit personal ose të banesës ndaj deputetit.

19. Për rrjedhojë, Rregullorja e Kuvendit ka parashikuar se Kryetari ka rol formal vetëm për përcjelljen e kërkesës për dhënien e autorizimit, ndërkohë që vendimi i takon trupës së deputetëve në seancë plenare. Deputetët (çfarëdo grupimi/entitet që nuk është arritur të përcaktohet nga shumica) nuk kanë asnjë mundësi për nisjen e procedurave të tilla parlamentare që lidhen me dhënien e autorizimit, përveçse të kërkojnë verifikimin e veprimtarisë së organeve gjyqësore nëse veprojnë në kundërshtim me normën kushtetuese dhe nëse shkelin kompetencat e Kuvendit, organit kolegjal pjesë e të cilit janë.

20. Nuk arrij të evidentoj nëse shumica ka bërë ndonjë interpretim të normave kushtetuese përmes këtij vendimi, kompetencë që ritheksoj e ushtron në çdo rast që vepron mbi bazën e juridiksionit të saj, pra nëse ajo ka konsideruar Kuvendin si organin e vetëm që vë në lëvizje Gjykatën në një rast të tillë. Por është e vështirë për mua të imagjinoj një skenar të mundshëm për të pasur një çështje kushtetuese në situatën konkrete ku Kuvendi nuk është vënë në lëvizje për sa kohë që kompetencat e tij janë ushtruar nga një organ tjetër. E qartë është se Kuvendi nuk mund të vihet në lëvizje kryesisht dhe në këtë pikë nuk mund të identifikoj ndonjë subjekt që mund të legjitimohej për të kërkuar ndonjë zgjidhje konflikti kompetencash në mënyrën që shprehet shumica. Kuvendi, ka thënë Gjykata, shfaqet si interpretuesi i parë i normës kushtetuese gjatë zbatimit të saj (*shih vendimin nr. 16, datë 27.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Por kur Kuvendi nuk vihet në lëvizje në mënyrë që të interpretojë normën kushtetuese gjatë zbatimit të saj, a nënkuptohet se legjitimohet çdo veprimtari jokushtetuese e organeve të tjera që e kanë anashkaluar atë me ose pa qëllim? Nga ana tjetër, thotë Gjykata, parimi i autonomisë parlamentare nuk duhet kuptuar si një mundësi për Kuvendin që, përmes vendimeve të shumicës parlamentare, të kufizojë mundësinë e Gjykatës për t'u shprehur për

themelin e çështjes (*shih vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në të njëjtën linjë me qëndrimin e Gjykatës a mundet që një organ tjetër përmes vendimmarrjes së tij në interpretim të një norme kushtetuese, të përjashtojë Kuvendin nga ushtrimi i kompetencës kushtetuese, por qoftë edhe nga mundësia e dhënies së interpretimit origjinal të saj, duke kufizuar në këtë mënyrë edhe mundësinë e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar të tilla çështje?

21. Qasja ime është se qartazi kemi një rast të konfliktit të kompetencave që ka ardhur nga mënyra e interpretimit autonom që organet gjyqësore i kanë bërë normës kushtetuese, i shfaqur në formën e vendimeve që janë kërkuar të pezullohen. Konflikti i kompetencave shfaqet si në formën e ushtrimit të kompetencave nga një organ tjetër, në këtë rast SPAK-u dhe GJKKO-ja, apo përmes pengimit të një organi t'i ushtrojë ato, në këtë rast mosparaqitja e kërkesës për autorizim ka penguar Kuvendin të shprehet dhe të ushtrojë kompetencën sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Neni 134 i Kushtetutës, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën për ushtrimin e kompetencave sipas nenit 131, nuk ka parashikuar Kuvendin, ndonjë organ drejtues të tij, komisione ose këshilla apo ndonjë entitet të posaçëm. Kushtetuta ia ka dhënë këtë të drejtë vetëm jo më pak se një të pestës së deputetëve. Ajo jo më kot ka njohur të drejtën e këtij subjekti për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues dhe jurisprudenca kushtetuese ka analizuar arsyet se përse ky grupim vjen në këtë gjykim në ndryshim nga çdo grupim tjetër parlamentar, pa pasur nevojë të argumentojë dhe justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete.

22. Kryetari i Kuvendit nuk kishte asnjë pengesë në këtë rast që në aspektin formal të niste procedura parlamentare, të thërriste seancën plenare, të niste kontroll kushtetues apo të kërkonte interpretim të nenit 73 të Kushtetutës. Parimisht ai duhej dhe mund ta kishte bërë një gjë të tillë që t'i jepte mundësinë Gjykatës të vendoste përfundimisht për një mosmarrëveshje kushtetuese që ishte ngritur tashmë nga deputetët dhe që ka shkaktuar edhe përplasje politike edhe mes shumicës e pakicës, të cilat kanë shfaqur qëndrime të ndryshme për mënyrën e zbatimit të normave kushtetuese. Mosveprimi i kryetarit të një organi kolegjal është e pamundur nga pikëpamja kushtetuese të shndërrojë konflikte kushtetuese në thjesht politike, të kufizojë subjektet kushtetuese dhe juridiksionin kushtetues, ndaj jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka përcaktuar një grupim të posaçëm brenda një organi kolegjal që ka të drejtën dhe aftësinë të kërkojë kontrollin edhe të vetë organit ku ai bën pjesë për mënyrën se si ushtron kompetencat dhe veprimtarinë e tij apo të kërkojë mbrojtjen kur këto kompetenca ushtrohen nga organe të tjera në kundërshtim me parashikimet kushtetuese.

23. Sipas shumicës, në një arsyetim *a contrario*, nëse do të pranohej ideja që një subjekt kushtetues ka interes të pakufizuar për çdo lloj konflikti të perceptuar prej tij si mosmarrëveshje kompetencash midis organeve kushtetuese, atëherë do të lindte rreziku që potencialisht subjekte/organe kushtetuese të treta, që nuk janë mbartëse të kompetencës në konflikt, t'i drejtoheshin Gjykatës në vend të atyre të cilave u përket kjo kompetencë, çka do të krijonte një mjet të panatyrshëm ankimi kushtetues që nuk pajtohet me parimin e ndarjes së pushteteve dhe funksionin e kontrollit kushtetues për këtë qëllim (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Kjo qasje është e përgjithshme dhe formaliste po aq sa e paqartë për sa kohë që kërkesa ka ardhur nga një e pesta e deputetëve për një kompetencë që duhet të ushtrohet nga organi kolegjial të cilit i përket dhe për sa kohë që nuk evidentohet konflikti i mundshëm që mund të shkaktohej nëse Gjykata, e vetmja që ka kompetencë në këtë çështje, të investohej për zgjidhjen e konfliktit. Qëndrimi im qartazi nuk përfshin një të pestën e deputetëve në çdo konflikt kompetence (p.sh. mes organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore). Qëndrimi im, që vlerësoj do të duhej të ishte analizuar në mënyrë të plotë dhe të qartë nga Gjykata, lidhet me qëllimin e këtij subjekti për të kërkuar mbrojtjen e kushtetutshmërisë, sa herë ajo vihet në dyshim ose në diskutim, duke i lënë kësaj Gjykate fjalën e fundit.

24. Në përfundim, mbi sa kam parashtruar, në vlerësimin tim çështja do të duhej t'i nënshtrohej shqyrtimit në seancë plenare për sa kohë ajo (kërkimet) hyn në juridiksionin kushtetues dhe kërkuesi legjitimohet për të gjitha këto kërkime.

Anëtare: Sonila Bejtja